

## PROCESVERBAL

(Ekstrakt)

*Nga mbledhja e IV-të (katërt) e Komitetit për Politikë dhe Financa - Dragash, e mbajtur më 30.03.2022, ora 09<sup>00</sup>, me këtë:*

### *REND DITE*

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e VI-të.
3. Eventuale....

**z. Uran Halimi** - A ka kush me e marr fjalën? Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, Kush është pro me 6 vota, Miratohet. Kush është pro miratimit të proces verbalit, vërejtje për proces verbalin? Kush është pro 6 vota pro miratohet.

#### **Pika e II - Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e VI-të**

**Pikat e propozuara për këtë seancë janë:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e IV-të,
2. Formimi i komisionit për grumbullimin e dëshmimeve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit lidhur me ankesën e z. Feim Sali,
3. Emërimi i komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale,
4. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale (Barnatorja),
5. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale ( Morena),
6. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale ( Byfeja e Komunës),
7. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022,
8. Raporti i shpenzimeve Janar- Dhjetor 2021,
9. Planet e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022,
10. Raporti i Punës së Ekzekutivit për vitin 2022,
11. Eventuale.

**z. Uran Halimi** - A ka dikush me shtuar ose me diskutuar rreth Formimit të komisionit për grumbullimin e dëshmimeve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit lidhur me ankesën e z. Feim Sali,

**Artan Ioshaj**- Po më duket e pa arsyeshme me diskutua këtu pasi po mungon kryetari i Komunës dhe kjo praktik herëve të kaluara nuk ka qenë ai i ka edhe 2 nënkryetar edhe është dashur njëri prej tyre me qenë pasi që në seancën e kaluar në eventuale Kryetari e qiti një propozim dhe i emërojë të gjithë anëtarët e komisionit, ndërsa sot nuk e ka asnjë anëtar të komisionit unë e di

që dy duhet me qen nga ekzekutivi për me vazhduar seanca, dy duhet prej ekzekutivit e tre prej Kuvendit muj me e propozuar sot, herën e par Kryetari i ka propozuar anëtarët e Kuvendit ndërsa veç Kuvendi ka drejt me i propozuar nuk e di se a mundemi me e vazhdu seancën, qe 14 vjet jemi këtu kurrë nuk ka ndodh me munguar Kryetari ose Nënkryetari.

**z. Uran Halimi** - Po e lëmë për nesër te eventuale ndoshta i jep emrat po vazhdojmë te pika e tretë - Emërimi i komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, duke e pa se veç e kemi të emëruar komisionin qoftë se ka dikush vërejtje për pikën e tretë?...

**Artan Ioshaj**- Prapë për këtë pikë komisionin që e ka themeluar kryetari i Komunës i ka 5 anëtarë po e shohë se është politike se nga opozita nuk ka asnjë asambleistë por ky i ka votat dhe e voton, por problemi është se Sejfidin Mejzini dhe Xhyfërije Bahtijari janë nga Kuvendi unë e di që kryetari nuk ka të drejt me bo propozime nga Kuvendi dhe ne nesër në seancë duhet vet na të bëjmë propozime edhe një vërejtje na jemi delegat të zgjedhur nga populli me ruajt identitetin.

**Munir Jonuzi**- shkurtimisht desha me ju përgjigj Artanit se tha që nuk ka delegat nga opozita, pjesëtarët e opozitës janë të përfshirë në organet udhëheqëse dhe plotësisht e përkrahi këtë përbërje dhe gjithashtu mendoj se ky komision është një gabim në qoftë se e mbani mend një mbledhje që është mbajtur në shkurt është bërë ndryshimi dhe në vend të Xhyfërije Bahtijari është zgjedhur Dritan Ademi megjithatë ky gabim nuk është bo nga shërbimi këtë e ka bo procesmbajtësi.

**z. Uran Halimi** - sa i përket këtij propozimi ky është krejtësisht i ri pasi ato të ma hershmet kanë dështuar dhe ky është komision i ri i cili është propozuar para mbajtjes së kësaj seance e jo ma herët, kështu që kemi nesër mundësi me propozuar anëtar të ri.

**Munir Jonuzi**- ky vendim e ka kaluar Kuvendin e kemi pasur propozimin rreth kësaj pike ku thotë të hiqet Xhyfërije Bahtijari dhe në vend të saj të propozohet një person tjetër nga PDK-ja dhe përfaqësuesi i PDK Shpejtim Hajredini, dhe pasi kemi ndryshime të fundit dhe pajtohemi që një person nga PDK-ja të jetë Driton Ademi dhe ky vendim është aprovuar me 24 vota pro.

**z. Uran Halimi** - Vazhdojmë tek pika 4,5,6 pasi janë të njëjta qoftë se pajtoheni.

**Artan Loshaj**- Është mirë që procesverbalin me ja que Kryetarit me e lexua se nuk ka përfaqësues me ja përcjell, këto tri lokale u dashtë me i qit në rend të ditës, unë e kam një pyetje për Kryetarin K.K Dragash i ka mbi 40 lokale në pronësinë e vetë po me duket e dyshimtë kjo ose po dojn me i bo favore lokaleve ose po dojn me i ndëshkua Kryetari është dashur me e marr listën e personave listën e lokaleve dhe me na njoftua dhe unë mendoj që këtë pikë duhet me e largua krejt për një seancë tjetër deri sa të na bien listën komplet, sepse ka disa që nuk kanë as kontratë me Komunën pasi që pasi të kryhen procedurat kontrata bëhet mes Kryetarit dhe pronarit dhe Kryetari i Komunës duhet me pas njohuri por siç po shifet këtë e ka bo z. Qmail Kolloni , dhe duhet sqarime. Edhe po dua ta di se sa borxhe kanë qeto lokale edhe çka kanë me bo ma tutje me këto lokale. Për fund ose të na jep nesër Kryetari sqarime ose nëse nuk na jep sqarime le të shtyhet për seancë tjetër.

**z. Uran Halimi** - Vazhdojmë tek pika 7. A dëshiron dikush me e marr fjalën?... JO.

Vazhdojmë tek pika e 8 a dëshiron me e marr fjalën dikush?....

**Artan Loshaj**- Raporti i shpenzimeve Janar- Dhjetor 2021, Planet e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022, Raporti i Punës së Ekzekutivit për vitin 2022, Eventuale. Pa prezencën e Kryetarit nuk kemi se çka bisedojmë edhe mendoj se kjo seancë duhet me u mbyll edhe ju delegat të pozitës thuani Kryetari tuaj le të vjen se 12 vjet kurrë Kryetari nuk ka munguar.

**z. Uran Halimi** - Tek eventuale e kemi një shqetësim e kemi një mori kërkesash për ndihmë shëndetësore që e kanë bo qytetarët me të njëjtat janë drejtuar edhe Kryetarit, kërkesa për ndihma në para për mjekim, unë kisha propozuar që këto me ja kaluar në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe ai le të ju ndihmon, ka kërkesa me vlerë mbi 2000 euro p.sh kryqi kuq ka bo kërkesë mbi 2000 euro dhe kërkesë për regjistrim të automjeteve 360 euro, goma të automjetit 294 euro etj. Dhe është mirë që këto kërkesa me ja deleguar Kryetarit që të merret ai me to.

**Artan Loshaj**- Desha me të treguar se si kanë shkuar gjerat ma herët, në kohën e Salimit Kryesuesi kërkesat ja ka dërguar atij ndërsa në kohën e Shabanit u tutke me marr vendim na bike komitetit, po ta jap si propozim deri 999.00 euro është se Kryetari mundet vet me marr vendim pa e pyetur Kuvendin, prej 1000€-1999€ ka të drejt me i dhënë Komiteti, ma herët ka qenë një komision prej 3 anëtarëve se di a është ende valid qoftë se është ai duhet ti shkohet komisionit për shëndetësi dhe ata i caktojnë diagnozat, dhe për shumën traditë ka qenë me caktuar Kryetari se se dimë sa sa mjete ka.

**z. Uran Halimi** - na e kemi një kërkesë prej 5200€ na nuk jemi edhe ekspertë që me e hulumtua lëndën e këtij rasti.

**Arjeta Skeraj**- Ato që janë me shuma të mëdhaja gjithmonë janë dërguar te Kryetari dhe në bashkëpunim Kryetari dhe KPF e kanë marr një vendim, kërkesat e vogla duhet me i hulumtua që mos me dal edhe na keq edhe Kryetari keq, është mirë që në Komitetin e radhës le të jetë edhe Kryetari këtu edhe e kalojmë.

**z. Uran Halimi** - I kemi dy kërkesa që këto pika të rendit të ditës me u shty deri sa të vjen Kryetari, apo me ja delegua këto kërkesa Kryetarit.

**Arjeta Skeraj**- kërkesat për shëndetësi edhe ma herët janë bart që të gjitha komisionit që ka qenë i zgjedhur për këtë punë për tjerat deri në Komitetin tjetër nuk e votoj.

**z. Uran Halimi** - Kush është pro që këto kërkesa ti bartën kryetarit? me 6 vota pro Aprovohet.

**Artan Loshaj**- Unë ditën e shtunë kam qenë në punë edhe K.K e i ka vendosur do logon të automjeteve edhe unë sa e di QKMF-ja e ka logon e vet edhe këta ja kanë vu edhe një po më duket marketing apo "shminka" na kemi probleme të mëdhaja në shëndetësi si mungesa të jashtëzakonshme të barnave nga lista esenciale nuk bien ma herët traditë e Kryetarit ka qenë

edhe e Drejtorisë së Shëndetësisë që kanë ble barna për kujdestari e tash e 2-3 muaj na punojmë ma keq se në vitin 99 ka mungesë shumë të barnave, këtë e ndalës e ka bo D.F pasi sipas tij kemi bo keqpërdorime unë shëndetësinë e kam pik të dobët dhe po shpresoj se kërkesat e mija të merren ma seriozisht. E qoftë se ka keqpërdorime le ti qojnë në gjykata bash kam qejf ama me hi pa diçka esenciale në kujdestari është e pa pranueshme.

**z. Uran Halimi-** Qoftë se nuk keni me shtuar diçka e konsideroj të mbyllur.

***Kryesuesi i Komitetit: Uran Halimi***

---